



# AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

RAPORTI VJETOR

*2018*

[www.atp.gov.al](http://www.atp.gov.al)

**PËRMBAJTJA E LËNDËS**

Hyrje.....	1
1. Vlerësimi dhe ekzekutimi financiar të vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit .....	2
1.1. Vlerësimi Financiar i Vendimeve përfundimtare .....	2
1.2. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare .....	3
1.3. Për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI) .....	5
1.4. Për procesin e tjetërsimit të sipërfaqeve të shtetërore (oborreve në përdorim) .....	5
2. Trajtimi i numrit të kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara të ndara sipas qarkut dhe në shkallë vendi si dhe për llojin e pasurisë së pretenduar .....	6
2.1. Trajtimi i kërkesave të reja të depozituara për njohje pronësie.....	6
2.2. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim .....	7
3. Çështjeve të ndjekura e të ankimuar në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre.....	10
3.1. Përfaqësim Ligjor pranë gjykatave.....	10
3.2. Ekzekutimi i detyrimeve të ardhura si rezultat i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. 10	
4. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucione të tjera.....	12
4.1. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të ligjit 133/2015 .....	12
4.2. Raportime periodike Mujore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS).....	12
5. Kërkesa të depozituara pranë sporteleve të atp-së si dhe ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes.....	14
5.1. Kërkesa të depozituara në sportelet e ATP-së.....	14
5.2. Shërbime të ofruara nga Atp nga bashkëpunimi ndërmjet AKSHI dhe ADISA.....	15
5.3. Ankesa të trajtuara të ardhura nga bashkëqeverisja.....	15
6. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompesimit .....	16
6.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2018 duke u bazuar në 6 mujorin e parë, i pa kuadruar nga dega e thesarit .....	16
6.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, janar-dhjetor 2018 .....	16
7. Mbi detyrat e lëna nga Komisioni për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut.....	17

## Hyrje

Agjencia e Trajtimit të Pronave ushtron aktivitetin e saj në bazë të Ligjit 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", i miratua me datë 5 dhjetor 2015 dhe botuar në Gazetën Zyrtare me datë 08.02.2016, si dhe akteve nënligjore VKM nr.221/2016; VKM nr.222/2016 e ndryshuar me VKM nr.765/ 2017; VKM nr.223/2016 e ndryshuar me VKM nr.766/2017

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) në zbatim të pikës 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 221, datë 23.3.2016, "*Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronës*", **paraqet raportin vjetor të punës për periudhën janar-dhjetor 2018.**

Ky raport reflekton punën e ATP përgjatë vitit 2018 duke dhënë informacionin për objektivat e arritura gjatë këtij viti.

Agjencia e Trajtimit të Pronave gjatë vitit 2018 ka fokusuar punën e saj në permbushjen e dy prioritetëve kryesore me afat 3 vjeçar prej hyrjes në fuqi të ligjit.

Ligji 133/2015 ka hyrë në fuqi me datë 23.02.2016 duke përcaktuar një afat 3 vjeçar si për vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare ashtu dhe për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie. Ndërsa për periudhën 10 vjecare, nga hyrja në fuqi e ligjit, ATP është e ngarkuar që të kryej ekzekutimin e vendimeve përfundimtare që janë vlerësuar financiarisht sipas mënyrë dhe formave të përcaktuara në VKM 223/2016 të ndryshuar.

Stafi i Agjencisë së Trajtimit të Pronës është angazhuar dhe ka arritur të përfundojë para afatit një nga proceset më të rëndësishme, që është ai i Vlerësimeve financiare të vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit me qëllim nxjerrjen e një fature financiare, si dhe ndjekjen procedurave për ekzekutimit të tyre.

Sa i takon procesit të shqyrtimit të kërkesave për njohje pronësie, evidentojmë faktin se ky proces pësoj një ndalim pas vendimit të Gj.K nr.1 e cila konstatoi si të papajtueshmë me kushtetuten disa dipozita të ligjit që kishin të bënin pikërisht me këtë proces. Pas reflektimit të qëndrimeve të mbajtuara nga ana e Gjykatës Kushtetuese, që u materializuan në aktet nën ligjore të miratuara në dhjetor të vitit 2017, konkretisht VKM 765 dhe 766. ATP ka vijuar punën për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie duke shfrytëzuar maksimalisht të gjitha burimet njerëzore në dispozicion në mënyrë që të trajtonte kërkesat e sa më shumë subjekteve pretendues

## 1. Vlerësimi dhe ekzekutimi financiar të vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit

### 1.1. Vlerësimi Financiar i Vendimeve përfundimtare

**Gjatë vitit 2018**, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vijuar punën me vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare për kompensim, **duke përfunduar vlerësimin financiar te 9458** vendimeve te pa vlerësuar më parë, nga ky vlerësim rezultuan të dhënat si më poshtë:


- ▶ 8642 vendime u vlerësuan financiarisht me një vlerë prej **34 156 228 643** lekë, vlerë e cila pritet të ndryshojë pasi ATP-ja është në pritje të përfundimit të ankimeve nga subjekti në bazë të afateve ligjore
- ▶ 632 vendime konsiderohen të kompensuara referuar nenit 7, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 133/ 2015 dhe pikës 3, gërma “c/ii” të VKM-së nr. 223/2016 i ndryshuar.
- ▶ 184 vendime u njohën me të drejtën e parablerjes.

Përgjatë 3 viteve Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vlerësuar **gjithsej 25 314** vendimeve përfundimtare për kompensim të viteve 1993 – 2013, vlerësim prej të cilit rezultuan të dhënat si më poshtë:

- ▶ 22 428 vendime u vlerësuan financiarisht me një vlerë prej **96 495 445 182** lekë vlerë e cila pritet të ndryshojë pasi ATP-ja është në pritje të përfundimit të ankimeve nga subjekti në bazë të afateve ligjore. Ky proces do të përmbyllet brënda afatit ligjor të përcaktuar në ligj, duke u publikuar regjistri i përditësuar i vendimeve në buletin e njoftimeve zyrtare.
- ▶ 2368 vendime konsiderohen të kompensuara referuar nenit 7, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 133/ 2015 dhe pikës 3, gërma “c/ii” të VKM-së nr. 223/2016 i ndryshuar.
- ▶ 518 vendime u njohën me të drejtën e parablerjes.

*Ecuria e procesit të vlerësimit financiar në ATP për vendimet 1993-2013*

Nr.	Procesi i vlerësimit financiar te vendimeve 1993-2013	Periudha pas miratimit të ligjit 133/2015			
		2016	2017	2018	Total
1	Numri i vendimeve te vlerësuar financiarisht	3925	11931	9458	<b>25314</b>



## 1.2. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2018, ATP ka regjistruar pranë sporteve 429 aplikime për kompensim financiar / fizik dhe janë ekzekutuar 18 vendime, duke shpërndarë:

- ▶ nga Fondi Financiar, një vlerë prej **35 521 553** lekë
- ▶ nga Fondi i Tokës, një sipërfaqe prej 568 909 m<sup>2</sup> me një vlerë financiare prej **116 637 991** lekë.

### Për kompensimin financiar me *kërkesë të veçantë*:

Gjatë periudhës *Janar - Dhjetor 2018*, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve me *kërkesë të veçantë* rezultoi:

- ▶ Janë pranuar 129 aplikime, nga të cilat 86 aplikime të reja dhe 43 dosje që kanë kaluar për trajtim nga Sektori Kompensimit Financiar dhe Fizik pranë sektorit të Trajtimit të Kërkesave të Veçanta me memo.
- ▶ Janë ekzekutuar 86 aplikime/dosje të cilat kanë përfituar kështu e parë.
- ▶ Fondi i cili do të lëvrohet për këto 86 aplikime është në total **1'507'504'425,56 lekë**.
- ▶ Buxhetit të Shtetit i është kursyer vlera **3'010'751'266,85 lekë**.
- ▶ Gjithashtu, është lëvruar kështu i dytë për 10 aplikime si dhe kështu i tretë për 2 aplikime. Është mbyllur procedimi administrativ për 4 aplikime.

Përgjatë kësaj periudhe, vihet re një tendencë në rritje ku subjektet përmes kërkesave të administruara kanë kërkuar kalimin për trajtim të dosjeve nga kompensimi financiar dhe fizik në kompensimin financiar me kërkesë të veçantë, gjithsej **43 kërkesa**. Kjo dencencë ka ardhur si pasojë e ndryshimeve të akteve nënligjore të cilat ndodhen në muajin Dhjetor të vitit 2017 për disa ndryshime në VKM nr.223/2016

Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka shpërndarë për kompensim financiar një vlerë prej **5 426 742 137 lekë** siç vijon:

- ▶ Gjatë vitit 2016 u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **1 826 870 845** lekë (një vlerë prej 1 805 417 553 lekë për kompensim financiar dhe një vlerë prej 21 453 292 lekë për kompensim financiar me kërkesë të veçanta).
- ▶ Gjatë vitit 2017 u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **2 056 845 314** lekë (një vlerë prej 1 959 411 055 lekë për kompensim financiar dhe një vlerë prej 97 434 259 lekë për kompensim financiar me kërkesë të veçanta).
- ▶ Gjatë vitit 2018 u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **1 543 025 978, 56** lekë (një vlerë prej 35 521 553 lekë për kompensim financiar dhe një vlerë prej 1 507 504 425, 56 lekë për kompensim financiar me kërkesë të veçanta).


Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka shpërndarë nga Fondi Fizik i pronave një sipërfaqe prej **380.3 Ha**, me një vlerë financiare prej **779 860 100 lekë**, si vijon:

- ▶ Gjatë vitit 2016 u shpërnda një sipërfaqe prej **658 899 m<sup>2</sup>** me një vlerë financiare prej 140,425,603 lekë.
- ▶ Gjatë vitit 2017 u shpërnda një sipërfaqe prej **2 575 064 m<sup>2</sup>** me vlerë financiare 522,796,506 lekë.
- ▶ Gjatë vitit 2018 u shpërnda një sipërfaqe prej **568 909 m<sup>2</sup>** me një vlerë financiare prej 116 637 991 lekë


*Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri janë kryer ekzekutime të vendimeve për kompensim si në tabelë:*

Trajtimi i kërkesave të veçanta pas miratimit të ligjit 133/2015	2016		2017		2018		Totale	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Numri dhe vlera e vendime të ekzekutuara për kompensim me kërkesë të veçanta	4	15,852,437	12	52,748,653	86	538,001,692	102	606,602,782
Vlera e llogaritur për kompensim financiar e kërkesave të veçanta		21,453,292		97,434,259		1,507,504,426		1,626,391,977
Vlera e kursyer shtetit		70,416,155		251,197,331		3,010,751,267		3,332,364,753

Grafiku paraqet vlerën financiare për vendime të ekzekutuara për kompensim me kërkesë të veçantë:



Grafiku paraqet vlerën e kursyer shtetit nga kompensimi financiar i kërkesave të veçanta për vitet 2016 -2018:



### 1.3. Për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)

Pranë ATP-së kanë aplikuar **1745 qytetarë** për periudhën janar-dhjetor 2018

- ▶ Janë ekzekutuar gjithsej 1727 kërkesa dhe është shpërndarë vlera financiare prej **2,147, 038, 233.81 lekë**


### 1.4. Për procesin e tjetërsimit të sipërfaqeve të shtetërore (oborreve në përdorim)

Bazuar në VKM nr. 578 datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, ndryshuar me VKM nr. 790 datë 14.11.2012. Për një ndryshim në vendimin nr. 578, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, rezulton se **gjatë periudhës janar – dhjetor 2018**

- ▶ Kanë aplikuar gjithësej 171 subjekte nga Bashki të ndryshme.
- ▶ Janë shqyrtuar dhe janë me vendimmarrje për 510 kërkesa
- ▶ Janë kryer 1020 konfirmime me institucionet të treta.

*Procedura e trajtimit të kërkesave për tjetërsim të sipërfaqeve shtetërore për 2014- 2018*

Periudha	Periudha në vite					Totali
	2014	2015	2016	2017	2018	
Numri i aplikimeve per hapje dosje nga qytetare per oborret ne perdorim	84	182	137	135	171	<b>709 +1088 te mbartura</b>
Numri i vendimeve per trajtimin e kerkesave qytetare per oborret ne perdorim	66	182	137	170	510	<b>1065</b>



## 2. Trajtimi i numrit të kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara të ndara sipas qarikut dhe në shkallë vendi si dhe për llojin e pasurisë së pretenduar

### 2.1. Trajtimi i kërkesave të reja të depozituara për njohje pronësie


Në zbatim të ligjit 133/2015, "Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave", dhe VKM-së nr. 222, datë 23.02.1016, "Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës", ndryshuar, për periudhën raportuese janar-dhjetor 2018 rezulton se:

**Gjatë periudhës janar - dhjetor 2018** kanë qenë të depozituara për shqyrtim gjithsej **12.950** dosje/praktika për 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë.

- ▶ Nga këto janë trajtuar **3000 kërkesa**.
- ▶ Aktualisht janë në proces trajtimi **9 950 dosje/praktika**.
- ▶ Për këtë proces, janë kryer njoftimet për plotësim dokumentacioni për **7150 dosje/praktika**.
- ▶ **10184** dosje (pretendimet, totali) janë hedhur në sistemin Web-Gis nga inxhinierët.
- ▶ Gjatë kësaj periudhe janë kryer kthim përgjigje subjekteve kërkuar dhe institucioneve zyrtare me objekte të ndryshme në kërkesat e tyre, rreth **2300 shkresa**.
- ▶ Gjithashtu janë pritur dhe janë sqaruar përfaqësuesit e subjekteve të pretenduar si të shpronësuar, të cilët janë orientuar për të plotësuar dosjet e tyre me dokumentacionin e nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjeve.

Informacionin po e paraqesim në tabelë edhe në mënyrë grafike:

Nr.	Ecuria e dosjeve ne shqyrtim	9m-1	3m-4	Viti 2018
1	Kërkesa të trajtuara	1 059	1941	3000
2	Dosje te hedhura ne web-Gis	8 840	1 344	10 184
3	Kthim përgjigje	1 712	588	2 300
4	Njoftime subjekteve pl.dos.	6 080	1 070	7 150



### Përmbyllja me vendim e kërkesave të pa trajtuara

Nga hyrja në fuqi e ligjit nr.133 / 2015 Agjensia e Trajtimit te Pronave ka trajtuar **6512 dosje / praktika**, siç vijon:



**Për vitin 2016:**

- ▶ Janë kryer procedura e kthimit të akteve (praktikat) subjekteve kërkues 503 kërkesa
- ▶ Janë kryer procedura me vendimmarrje për 480 dosje

**Për vitin 2017:**

- ▶ Janë kryer procedura e kthimit të akteve (praktikat) subjekteve kërkues 2164 kërkesa,
- ▶ Janë kryer procedura me vendimmarrje për 365 dosje

Indikatoret	2016	2017	2018	Totali	Proces trajtimi
Numri I vendimmarrjeve per kerkesat per njohje pronësie	983	2529	3000	6512	9950 dosje/praktika

Pas miratimit të ligjit 133/2015 pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë depozituar **në total 16479** dosje/praktika, **janë trajtuar me vendime 6512** dhe janë në **process trajtimi 9950 dosje/praktika**.


**2.2. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim**

Për herë të parë ATP-ja që nga koha kur i është dhënë me VKM nr.770/2014 fondi i tokës për kompensim fizik ka bërë të mundur **bllokimin dhe evidentimi i të gjithë fondit fizik prej 23,400 numra pasurish në qarqet Korçë, Berat dhe Gjirokastër dhe Elbasan**. Në këtë proces janë angazhuar fizikisht grupe pune nga ATP-ja, pranë zyrave të rregjistrimit për përmbylljen e këtij problemi që ndër vite ka qënë i pazgjidhur.

- ▶ Në zbatim të VKM-së nr.770/2014 “Për Kalimin në Fondin e Kompensimit Fizik, në Dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23 368.8 Ha” janë dërguar kërkesa për konfirmime për **16 223 numra pasurie** drejt institucioneve të ZVRPP-ve & Bashki-ve në Qarqet; Elbasan, Korçë, Berat, Gjirokastër dhe për dijeni Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën ka kërkuar bashkëpunimin e institucioneve për të përfunduar sa më shpejtë procesin e verifikimit të Fondit Fizik të Tokës Bujqësore, proces ky i lidhur ngushte me kthim-përgjigjet nga ZVRPP-te përkatëse në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga institucioni ATP-së.
- ▶ Janë kryer verifikime në terren të Fondit Tokës për kërkesat e subjekteve për kompensim të aplikuar në ATP. Janë verifikuar pasuri të ndodhura në qarqet Gjirokastër, Berat, Korçë dhe Elbasan, dhe këto pasuri kanë kaluar në favor të ATP-së për t’përdorur si Fond Kompensimi Fizik:

Për periudhën janar-dhjetor 2018 janë verifikuar në **total 365 numra pasurie** të cilat ndodhen në qarqet:

- ▶ 100 pasuri të ndodhura në qarkun Gjirokastër.
- ▶ 247 pasuri të ndodhura në qarkun Elbasan.
- ▶ 6 pasuri të ndodhura në qarkun Korçë.
- ▶ 12 pasuri të ndodhura ne qarkun dhe Berat.



Në bazë të VKM-se nr.1077/2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi pyjor dhe kullosor”, të ndodhura në Qarqet Berat, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Kukës, Shkodër, Tirane dhe Vlore, është **kërkuar informacion më i detajuar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për vendndodhjen e pronave me sipërfaqe totale prej 71699.3 ha pyje dhe kullota.**

**Problematika e konstatuar:** ka mospërputhje të sipërfaqeve pasi sipas shkresës nr.6918/1 prot, datë 15.07.2014 të Ministrisë së Mjedisit rezulton se sipërfaqja nuk është **71 699.3 Ha, por 50 989.76 Ha me një mospërputhje prej 20709.54 Ha.**

Gjatë procesit të bllokimit dhe evidentimi i të gjithë fondit fizik prej **23,400 numra pasurish në qarqet Korçë, Berat dhe Gjirokastër dhe Elbasan** janë konstatuar problematika pranë ZVRPP-ve. Nga bllokimi dhe evidentimi i rreth 13,055 pasurive në ZVRRPP përkatëse rezulton se një numër i konsiderueshëm pasurish të kaluara në administrim të ATP-së të jenë me problematika si më poshtë:

1. Pasuri të ndara sipas përcaktimeve të ligjit nr.7501 dt.19.07.1991 për tokën.
2. Bashki të cilat kërkojnë që pasuritë e kaluar me VKM 770/2014 në favor të ATP-së të hiqen nga fondi fizikë për Njësi Administrative përkatëse.
3. Pasuri të dhëna nga ish-Komunat me koncesion dhe qera në favor të personave të tretë.
4. Pasuri të cilat me akte të ndryshme i kanë kaluar në administrim ose pronësi institucioneve të tjera.
5. Pasuri të cilat janë fituar me vendime të KKKP-së në favor të ish-pronarëve.
6. Numra pasurish të cilat kane kaluar me VKM 770/2014 në favor të ATP por që nuk rezultojnë në volumet hipotekor.
7. Pasuri të cilat posedohen nga persona të tretë sipas librit te ngastrave.
8. Pasuri te okupuar nga persona të tret për të cilët sipas ZVRPP-ve i kanë me AMTP por nuk janë regjistruar në hipotek.
9. Pasuri të regjistruar në favor të institucioneve apo enteve të ndryshme, si dhe te komuniteteve fetare.
10. Pasuri të cilat i kanë kaluar në administrim ish- komunave me VKM dhe të dhëna me qera ose koncesion.
11. Pasuri të dhëna me qera personave te tret për 99 vjet nga ish komunat.

Nga problematikat e konstatuara sa më sipër, janë evidentuar një numër i lartë kërkesash nga ana e institucioneve të treta si dhe të subjekteve private me probleme për një sipërfaqe rreth 3700 ha, ku:

- ▶ Sipërfaqe Totale tokë bujqësore 23 368.8 Ha ose 100%
- ▶ Sipërfaqe e cila duhet të hiqet dhe zëvendësohet rreth 3700 Ha ose 16%.
- ▶ Sipërfaqe e mbetur rreth 19668.8 ose 84/%

### 3. Çështjeve të ndjekura e të ankimuar në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre

Një nga detyrat e ATP-së është dhe mbrojtja e interesave të ATP në tre shkallët e gjyqësorit dhe në gjykatën Administrative për vendimet e dhëna ndër vite, bazuar në legjislacionin në fuqi, është ndjekur si më poshtë:

#### 3.1. Përfaqësim Ligjor pranë gjykatave

**Për periudhën janar –dhjetor 2018:**

- ▶ Janë administruar padi për periudhën 1326 padi të reja nga të gjitha gjykatat e rretheve.
- ▶ ATP ka ushtruar 61 ankime dhe 94 rekurse.
- ▶ Janë rrëzuar nga gjykata 122 padi
- ▶ Janë pranuar nga gjykata 200 padi
- ▶ Janë kthyer dhe pushuar nga gjykata 171 padi

Për periudhën nga Janari 2018 deri në dhjetor 2018 në Sektorin e Përfaqësimit Ligjor janë depozituar 1326 padi në të gjitha gjykatat e vëndit, në gjykatat e rretheve, në gjykatat e apelit, në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe në apelin administrativ.

Në lidhje me vendimmarrjen e ATP sa i takon njohjes të së drejtës së pronësisë sipas kushteve të ligjit 133/2018 janë depozituar 162 padi nga ku janë rrëzuar 18 dhe janë pranuar 7. Vlen të theksohet se Gjykata e Apelit në këto gjykime gjykon me juridiksion fillestar.

Në lidhje me vlerësimet financiare për vendimet që kanë njohur të drejtën e kompensimit për vitin 2018 janë depozituar në ATP, 247 padi ku kundërshtohet vlerësimi financiar i vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit. Nga këto 62 janë rrëzuar ose pushuar, ndërsa 13 janë pranuar.

Gjatë vitit 2018 janë hedhur në ëeb zyrtar të ATP-së rregjistrin elektronik 1638 vendime të Gjykatave të cilat kanë ndryshuar në kohë vendimet e ish Agjencie. Pasqyrimi I vendime në rregjistrin elektronik ka shërbyer sektorëve vlerësimin e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit si dhe për procesin e trajtimit të kërkesave të reja për njohje pronësie.

#### 3.2. Ekzekutimi i detyrimeve të ardhura si rezultat i vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Me hyrjen në fuqi të 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përthithur edhe të drejtat e detyrimit e ish-komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronës, të ish-zyrave rajonale të kthimit dhe kompensimit të pronave si dhe të ish-Agjencisë së Kthimit të Pronave.

Në ATP janë administruar 192 kërkesa, vetëm për vitin 2018 janë administruar 32 kërkesa të reja për shlyrje detyrimesh të cilat janë depozituar si nga kreditorët me kërkesë ashtu dhe nga zyrat përmbarimore.

Duke referuar Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 për “Mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesar” është bërë publike në faqen zyrtare të saj afishimin e kreditorëve sipas rradhës hyrës të kërkesave.

Kërkesat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të depozituara pranë institucionit janë të disa tipologjive, të cilat nga ana e Agjencisë janë ndarë në tre grupe.

- ▶ Ekzekutim të vendimeve gjyqësore sa i takon vetëm për shpenzimet gjyqësore dhe përmbarimore;
- ▶ Ekzekutim të vendimeve gjyqësore sa i takon demshpërblimeve për largimin nga puna;
- ▶ Ekzekutim të vendimeve gjyqësore që janë për detyrimin e kompensimi financiar e subjekteve të shpronësuara;
- ▶ Ekzekutim të vendimeve gjyqësore që janë me detyrim për nxjerrje akti nga ATP.

Për vitin kalendarik 2018, ATP-së i janë akorduar nga buxheti i shteti për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore 13,164,203 lekë nga kjo vlerë është lëvruar shuma prej **7,677,338 lekë**.

- ▶ Janë ekzekutuar 58 vendime gjyqësore me vlerë 7,677,338 lekë
- ▶ 26 kërkesa nuk kanë patur detyrime
- ▶ 12 kërkesa janë pushuar
- ▶ 96 kërkesa nuk janë ekzekutuar për mosplotësim dokumentacioni nga ana e kreditoreve pavarësisht se janë njoftuar.
- ▶ 15 nga keto kërkesa janë pezulluar me vendim gjyqësor.

#### 4. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucione të tjera

Agjencia e Trajtimit të Pronave në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencinë e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informatë, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjëohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

##### 4.1. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të ligjit 133/2015

Raportime institucionale pranë Ministrisë së Drejtësisë referuar shkresave dhe informacionit të kërkuar për çështjen e pronave nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, siç vijon:

- ▶ Kontribute “Mbi takimin e nëntë të Komitetit të Stabilizim – Asociimit, KSA 2018”
- ▶ Bashkëpunime të ndryshme lidhur me përditësimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2018 – 2020 dhe për inicimit e hartimit të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2019 – 2021.
- ▶ Përgatitja e materialeve mbi fillimit të hartimit të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019, kontribut i cili u paraqit shërbimeve të Komisionit Evropian me datë 12 nëntor 2019 dhe një kontribut tjetër i cili përgatitet të paraqitet në fillim të vitit 2019.
- ▶ Raportime lidhur me Planin e Masave për rekomandimet e Progres Raportit të 2018, në lidhje me Kapitullin 23.
- ▶ Përgatitja e materialeve për Raportin e Parë Vullnetar për Shqipërinë, në kuadër të takimit të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).
- ▶ Përgatitja e materialeve të ndryshme në kuadër të monitorimit të rekomandimeve të adresuara nga Nënkomiteti i nëntë i “Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë” si dhe përgatitja e materialeve për takimin e dhjetë të Nënkomitetit “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, takim i cili u zhvillua në 12 – 13 korrik 2018 në Tiranë.
- ▶ Materiale të përgatitura në kuadër të takimit të dhjetë të Nënkomitetit për Çështjet ‘Ekonomi, Financë dhe Statistikë’, takim i cili u zhvillua me datë 27 shtator 2018 në Tiranë.
- ▶ Përditësime të informacioneve lidhur me të dhënat të pronës, si një nga pesë prioritetet e qeverisë.

##### 4.2. Raportime periodike Mujore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS)

###### Evidenca e raportimeve periodike mujore pranë ZOS janar-dhjetor 2018


Indikatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	TOTALI
Aplikime te plota	1107	1330	1279	1307	1499	1345	1134	834	994	1166	1044	871	13910
Aplikime te paplota												0	0
Aplikime te mbartura	343	210	366	228	218	383	272	224	235	208	226	227	3140
Total I sherbimeve te levruara	443	862	677	693	778	537	555	358	506	672	536	375	6992
Sherbime te levruara brenda afatit	308	744	471	579	660	463	506	306	416	612	456	329	5850
Sherbime te levruara jashte afatit	135	118	206	114	118	74	49	52	90	60	80	46	1142
Plotesim dokumentacioni	42	91	143	228	234	130	66	100	122	131	103	117	1507
Ankesa te reja	25	15	30	16	21	28	20	19	12	24	13	20	243
Ankesa te mbartura	6	23	16	26	19	26	29	30	34	28	35	36	308
Nr.pergj l ankesave te zgjidhura/shqyrtuar	8	22	20	23	14	25	19	15	18	17	12	15	208
Nr.ankesash te zgjidhura/shqyrtuara brenda afatit	5	4	14	10	8	15	11	5	7	10	7	7	103
Nr.ankesash te zgjidhura/shqyrtuara jashte afatit	3	18	6	13	6	10	8	10	11	7	5	8	105

**Raportime analitike pranë ZOS janar-dhjetor 2018**

Indikatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersho	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	TOTALI
Aplikime per kompensim nga ALUIZNI	265	186	166	117	146	220	152	110	92	74	105	112	1745
Aplikime per sherbime me vendimmarrje prane sektorit te tjetersimit te Oborreve	5	20	16	15	23	17	17	1	9	16	13	8	160
Aplikime per kalimin e praktikave ne cilesine e dosjes prane sektorit te Shqyrtimit te Kerkesave per Njohje Pronesie	15	23	13	29	22	16	10	6	13	9	19	5	180
Aplikime prane sektorit te kompensimit Financiar dhe Fizik	15	35	39	42	47	37	53	31	13	45	29	21	407
Aplikime per sherbime pa vendimmarrje	806	1065	1043	1100	1253	1049	893	682	863	1011	865	719	11349
Aplikime per Kompensim progresiv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Aplikime per kerkesa te vecanta	1	1	2	4	8	6	9	4	4	11	13	6	69
<b>Totali per cdo muaj</b>	<b>1107</b>	<b>1330</b>	<b>1279</b>	<b>1307</b>	<b>1499</b>	<b>1345</b>	<b>1134</b>	<b>834</b>	<b>994</b>	<b>1166</b>	<b>1044</b>	<b>871</b>	<b>13910</b>

Raportime periodike Mujore pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS) për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Ëeb-Gis.

Muaji	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	dhjetor	TOTAL
<b>Skanime</b>	550	417	617	609	537	177	699	438	491	578	484	97	5 694
<b>Hartografime</b>	230	145	125	888	669	560	2293	36	616	908	354	474	7 298



## 5. Kërkesa të depozituara pranë sporteleve të atp-së si dhe ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes


### 5.1. Kërkesa të depozituara në sportelet e ATP-së

Për periudhën janar-dhjetor 2018 pranë sporteleve të Agjencisë së Trajtimit të Pronave në lidhje me shërbimet që ofrohen ndaj qytetarëve, janë paraqitur dhe depozituar **7478 kërkesa qytetare, nga të cilat:**

- ▶ Kërkesa për informacion – 1879
- ▶ Kërkesa për kopje dokumentacioni - 1710
- ▶ Plotësim dokumentacioni – 1295
- ▶ Kërkesa për vlerësim vendimi – 1562
- ▶ Metodologji Vleresimi – 136
- ▶ Takime – 174
- ▶ Ankesa/ Te ndryshme (Oborre/Ekzekutim Vendime/Perfitime Kompensimi etj) -722

#### Evidencë e kërkesave qytetare të trajtuara nga ATP sipas 3 mujorëve

nr.	Kërkesa qytetare	3m-1	3m-2	3m-3	3m-4	Vjetore 2018
1	K/informacion	232	1216	181	250	1879
2	k/kopje dok.	265	760	291	394	1710
3	k/sek. Kompensimit	465	592	302	72	1431
4	k/plot.dokumentacioni	121	646	225	303	1295
5	k/ekzekutim vendimi	0	4	0	203	207
6	Te ndryshme(ankesa, kerkesa,takime)	0	95	175	686	956
	<b>Total kërkesa qytetare</b>	<b>1083</b>	<b>3313</b>	<b>1174</b>	<b>1908</b>	<b>7478</b>





## 5.2. Shërbime të ofruara nga Atp nga bashkupnimi ndërmjet AKSHI dhe ADISA

Agjencia e Trajtimit të Pronave në bashkëpunim me AKSHI dhe ADISA ka ofruar për qytetarët dhe subjektet e interesuara shërbimet e mëposhtme:

- ▶ Në portalin qeveritar e-albania, janë publike shërbimet e reja elektronike të ofruara nga institucioni dhe janë trajtuar në total janar-dhjetor 376 kërkes/ankesa, ku:
  - Janë **223 ankesa dhe trajtim i dosjes me specialistin përkatës pranë ATP**
  - Janë **153 kërkesa për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes.**
- ▶ Nga Portali ONE STOP SHOP kryhet Gjenerimi i dokumentacionit ( certifikata).

*Stafi i ATP “si përdorues të Portalit Qeveritar” merret me procedurat e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe akseson nga sistemi dokumente si certifikata për qytetarët.*

Agjencia e Trajtimit të Pronave në bashkëpunim me ADISA ka kryer hartimin dhe validimin e kartelave Informative të Shërbimeve që ofron për qytetarët, duke i bërë publike ato.

## 5.3. Ankesa të trajtuara të ardhura nga bashkëqeverisja

Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë paraqitur nga zyra e bashkëqeverisjes me qytetarët **843 ankesa.**

Nga janar 2018 deri në dhjetor 2018, janë trajtuar me përgjigje **843**, ankesa qytetarësh të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, te trajtuara me përgjigje, nga të cilat:

- ▶ 6 Mujori i parë (Janar - Qershor 2018) – 360 Ankesa të trajtuara.
- ▶ 6 Mujori i dytë (Korrik – Dhjetor 2018) 483 Ankesa të trajtuara nga te cilat :
  - 135 kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e kompensimit financiar/fizik.
  - 149 kërkesa/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e vendimmarrjes për Njohjen e Pronësisë.
  - 16 kërkesa/ankesa për Sektorin e Oborreve në përdorim
  - 15 kërkesa/ankesa për Sektorin e Përfaqësimit Ligjor

Indikatoret ATP	1	2	3	4	5	6
	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Numri i kerkese/ankesave te ardhura nga qytetaret ne sportele dhe portalet elektronike	5682	3895	6583	16136	2552	1621



**6. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompesimit****6.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2018 duke u bazuar në 6 mujorin e parë, i pa kuadruar nga dega e thesarit**

Nr	EMERTIMI	Llog. Ekon.	Buxheti 2018 Pas Aktit Normativ 2	Fakti 3 Mujor I Fundit	Fakti 12 Mujor
1	Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	600	131,112,000.00	32,284,954.00	119,951,610
2	Kontributi i sigurimeve shoqerore dhe shendetësore	601	21,888,000.00	5,357,583.00	19,897,805
3	Mallra dhe shërbime te tjera	602	70,000,000.00	23,416,677.00	43,115,512
4	Transferime korrente të brendshme	604	2,538,216,911.00	1,313,216,911.00	2,538,216,911
5	Transferta per Buxhetet familiare dhe indi	606	100,000.00	-	100,000
6	Shpenz. Për ritjen e aktiveve të Trupëzuara	231	10,500,000.00	5,487,600.00	6,351,600
7	Te Ardhura Jashtë Buxhetore		1,500,000,000.00	610,754,847	610,754,847
	<b>Total</b>		<b>4,271,816,911.00</b>	<b>1,990,518,572.00</b>	<b>3,338,388,285</b>

**6.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, janar-dhjetor 2018**

Kodi i Llogarisë Ekonomike	Tarifat	3 Mujori i katërt 2018	Total 2018	Komente
7110105	Tarifa për Aktet - Administrative	1,466,460	7,107,935	Derdhur në Buxhet
7110114	Të ardhura nga Tjetersimin Siperfaqeve Shtetërore	10,900,000	28,518,000	Te ardhura qe merr ATP
7111099	Të tjera të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	-	21,070	Derdhur në Buxhet
7109901	Të ardhura të krijuara nga pagesa e vlerës së llogaritur të tokës	-	955,256	Te ardhura qe merr ATP
7109902	Të ardhura nga kalimi i pronësisë së pasurive të paluajtëshme e të truallit funksional të tyre	100,000	8,725,920	Te ardhura qe merr ATP
7109903	Të ardhura nga privatizimi i banesave shtetërore dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive shtetërore	13,723	17,735	Te ardhura qe merr ATP
	<b>Total</b>	<b>12,480,183</b>	<b>45,345,916</b>	

## 7. Mbi detyrat e lëna nga Komisioni për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut

ATP-ja gjatë prezantimit të raportit vjetor 2017 pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ju la si detyrë që të verifikonte ecurinë e çështjeve të ngritura nga Task Forca pranë Kryeministrisë për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajshme shtetërore.

ATP-ja në vijim të detyrave të lëna ngriti një grup pune me urdhër nr. 121 prot., datë 19.04.2018 për verifikimin e ecurisë dhe marrjen e informacionit për kallëzimet penale të bëra nga ish-Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave sot Agjencia e Trajtimit të Pronave në kuadër të informacioneve të dhëna nga Task Forca e ngritur me Urdhër Kryeministri nr.70, datë 13.02.2014 dhe nga Marrëveshja e Bashkëpunimit me Urdhër nr.2981 prot., datë 29.08.2015.

Nga verifikimi që është bërë pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe Avokaturës së Shtetit dhe shkresave zyrtare të ardhura nga këto institucione rezulton se:

- ▶ Për 30 (tridhjetë), kallëzime penale, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur pushimin e çështjes penale për shkak të parashkrimit të veprës penale.
- ▶ Për 3 (tre), kallëzime penale është vendosur mos fillimi i procedimit penal, për shkak të mungesës së veprës penale.
- ▶ Për 1 (një) kallëzim penal është vendosur nga Gjykata lënien ne fuqi të vendimit të Prokurorisë për pushimin e çështjes penale ;
- ▶ Për 1 (një) kallëzim penal është vendosur nga Prokuroria pushimin e pjeshëm të procedimit penal për disa shtetas te akuzuar dhe deklarimin fajtor te Timotheo Dhimolea për veprën penale të falsifikimit të dokumentacionit;
- ▶ Për 2 (dy) kallëzime penale është vendosur nga Gjykata deklarimi fajtor të të pandehurit Xhavit Çeliku si dhe Robet Koçi për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”;
- ▶ Për 2 (dy) kallëzime penale i janë dërguar Gjykatës për gjykim të çështjes penale;
- ▶ Për 1 (një) kallëzim Gjykata ka vendosur deklarim e pafajshëm të pandehurit Theodhori Koçani
- ▶ Për 9 (nëntë) kallëzime penale janë akoma nën hetim nga Prokuroria;